

RAPORT

MBI SHNDRIMIN E SHOQERISE PELIKAN SECURITY – 2 SHPK NE SHA

ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

PELIKANI SECURITY – 2 SHPK

Une, Aleksander Pinderi, administrator i shoqërisë Pelikani Security – 2 shpk në zbatim të nr.9901, dt.14.04.2008 “Per Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) neni 229. Pika 1 po i paraqes Asamblese së Përgjithshme të ortakëve, Raportin mbi Shndrrimin e Shoqërisë Pelikani Security – 2 shpk në shoqëri aksionare.

- Shoqërisë i janë ofruar mundësi për zgjerimin e veprimtarisë së saj në fushën e sigurisë së leasing financiar, si edhe ruajtja e gjerave me vlerë në caveaux dhe/ose kasaforta sigurie, menaxhimi isallave të numerimit dhe grumbullimit për përpunimin në përgjithësi të parave, çekëve të letrave me vlerë dhe kuponave të tyre, kredi të asimiluara në pronësi të paleve të treta, në përputhje me kërkesat ligjore, sipas kategorisë "C" të ligjit nr. Ligji Nr. 75, datë 10.07.2014 “Per Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, (SHPSH), si dhe çdo aktivitet ndihmes i nevojshëm për të përmirësuar dhe realizuar objektin e aktivitetit sipërpermendur. Ky aktivitet do të kryhet në bazë të lejeve dhe licencave përkatëse të lëshuara nga autoritetet kompetente. Prodhimi dhe shitja në të gjitha format e veshjeve, në veçanti të veshjeve teknike dhe ushtarake (uniformat e rojeve private, etj.) Menaxhimi i shërbimeve të sigurisë në zonat e portit dhe të aeroportit, veçanërisht mbikëqyrja e aeroportëve dhe portëve dhe pozicionëve veçanta brenda zonës së aeroportit dhe portit, që i takojnë shoqërive të menaxhimit, të transportuesit ajror ose tjetër ose një operatori tjetër të aeroportit dhe portit (hyrja, zyrat, portat e ngarkesave, perimetri i aeroportit dhe portit dhe uljet e levizshme); mbikëqyrja e magazinave të mallrave import-eksport dhe portat e tyre përkatëse, mbikëqyrja e mallrave me vlerë të veçante së bashku me shoqërimin –ruajtjen në magazinat e avionëve dhe/ose anije dhe / ose varkave dhe anasjelltas, shoqërimi–ruajtja e sendeve me vlerë të pasagjereve, kontrolli me rreze-x i bagazhit të regjistruar, bagazhit "Rush" dhe atij në dorë, njohja e bagazheve në bord; kontrolli i pasagjereve negatë/portat e hyrjes dhe në aeroplan dhe/ose anije përpara imbarkimit efektiv, intervista me pasagjeret para imbarkimit.
- Për të mundësuar zgjerimin e veprimtarisë në drejtimin e lartë përmendur duhet që shoqëria Pelikani Security – 2 shpk të riorganizohet në formën e shoqërisë aksionare. Shndërrimi i shoqërisë në shoqëri aksionare është në përputhje me ligjin nr.9901, dt.14.04.2008 “Per Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) neni 214 pika 2 dhe 3, sepse shoqëria Pelikani Security – 2 shpk është regjistruar në regjistrin tregtar 21.12.2006 me afat deri më dt.31.12.2020.



- Shoqëria do të shndërrohet në shoqëri aksionere sipas përcaktimeve, neni 228, pika 1/a e në vijim. Sipas ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 neni 228 pika 2 (i ndryshuar) "Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve". Të drejtat dhe detyrimet që shoqëria Pelikani Security – 2 shpk ka marrë përsipër ndaj të tretëve mbarten në formën e re të shoqërisë, pra në shoqërinë Pelikani Mondialpol sh.a
- Emiri i shoqërisë propozohet të jetë Pelikani Mondialpol sh.a.
- Kohëzgjatja e shoqërisë të jetë me afat deri në 31.12.2050.
- Shndërrimi i shoqërisë nuk do të ketë asnjë efekt tek punëmarresit e shoqërisë. Shoqëria Pelikani Mondialpol sh.a do të ripërterijë të gjitha kontratat me punëmarresit e shoqërisë Pelikani Security – 2 shpk.
- Para operacionit të shndërrimit kapitali i shoqërisë paraqitet si më poshtë:
Kapitali i nënshkruar dhe teresisht i paguar i Shoqërisë është 9.800.000 Leke, i cili përbehet nga 5.000 (pesemije) aksione me një vlerë nominale prej 1960 Leke secili. Kapitali i shoqërisë është në para sipas përcaktimeve të ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 (i ndryshuar) neni 108 i cili përcakton se kontributet e aksionerëve mund të jenë në para ose në natyrë.
Kuota në kapitalin e shoqërisë janë Vesel Demiraj 5000 mijë aksione. Aksionet e nënshkruara me kontribut në para nga aksioneri janë shlyer 100% në vlerën e tyre nominale.
- Pas shndërrimit të shoqërisë kapitali i shoqërisë paraqitet:
Kapitali i nënshkruar dhe teresisht i paguar i Shoqërisë është 9.800.000 Leke, i cili përbehet nga 5.000 (pesemije) aksione me një vlerë nominale prej 1960 Leke secili.
- Publikimi i shpalljes për shndërrimin e shoqërisë dhe thirrjen e ortakëve sipas neni 229, pika 3 të ligjit nr.9901, dt.14.04.2008 (i ndryshuar) nuk është i detyrueshëm pasi ortakët zotëruar 100% të kuotave të kapitalit është i pranishëm personalisht në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

Në mirëbesim të mjaftueshmerisë së informacioneve të këtij raporti mirëpres vendimin tuaj.

Tirana, më 30.03.2018

Administrator

Aleksander Pindori.

